

Mbledhje e KD-së

Sot në dt 17 Gusht 2020, kryesia e FSHB-së, nën drejtimin e Presidentit, z.Ponari dhe praninë e anëtarëve: z.Bicoku, z.Jarani, Znj.Alibegaj,z.Taflaj ,u mbledh për të diskutuar mbi Rendin e Ditës si vijon:

1. Relacion mbi situatën e mandateve të shoqatave, nga data 25 Qershor – 11 Gusht 2020 për realizimin e Asamblesë Statutore
2. Modalitetet e mbylljes së kampionateve kombëtare për të gjitha kategoritë
3. Diskutime mbi sezonin e ri 2020-21
4. Të ndryshme

Lidhur me pikën e parë të rendit të ditës, u raportua lidhur me situatën e dokumentacionit ligjor të shoqatave anëtare për ndryshimet sipas kërkesave. Administrata u ngarkua të ndjekë me intensitet si dhe të asistojë për mbarëvajtjen e procesit të rifreskimit të këtij dokumentacioni.

Lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës, vëmendje të veçantë, kryesia I kushtoi diskutimeve mbi mënyrën e mbylljes së kampionateve kombëtare për të gjitha kategoritë, meshkuj/femra, U18 djem/vajza, U16 Djem/Vajza, duke marrë në konsideratë të gjitha përpjekjet dhe investimet e shoqatave, ndeshjeve të zhvilluara dhe atyre të mbetura , deri në momentin e futjes në gjendjen e jashtëzakonshme me efekt global.

Ajo analizoi në mënyrë të detajuar, eksperiencat ndërkombëtare (të vendeve fqinje dhe europiane), për raste të tilla , rekomandimet e FIBA dhe vlerësoi alternativat më të favorshme, për të gjithë pjesëmarrësit.

Për këtë qëllim, pas një rezistence pritjeje për mbyllje në parket, duke marrë parasysh numrin e konsiderueshëm të ndeshjeve të pa zhvilluara nga faza e dytë e kampionatit si edhe play off- et respektive, e detyruar KD-ja :



Vendosi:

- 1.** Të gjithë kampionatet e basketbollit, në të gjitha kategoritë (femra/meshkuj, të rritur/a, rinj/reja, para të rinj/reja) do të mbyllen pa kampion, duke shpallur **edicioni 2019-20 Covid19**
- 2.** Në datë **15 Nëntor 2020**, do të fillojë edicioni i ri 2020-21 (masa për të cilin po merren në bashkëpunim me autoritetet përkatëse dhe bëhen me dije sapo të zbardhen dhe miratohen)
- 3.** Edicioni i ri 2020-21 do të zhvillohet me një kategori (një grup) si për femrat ashtu edhe për meshkujt
- 4.** Të ndiqet me vëmendje të veçantë situata e statusit të shoqatave nga administrata, si edhe përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për fillimin e edicionit të ri 2020-21

Shëndeti, siguria për komunitetin tonë të basketbollit , janë prioriteti ynë!

Avni Ponari

President



Korab Llazani

Sekretar I Përgjithshëm